



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e **Komitetit për Politikë dhe Financa** (KPF), e mbajtur më **18.12.2023**, me fillim në orën **10:10**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, **Arbër Zenuni**.

Kryesuesi: Fillimisht më lejoni t'ju përshëndes të gjithëve, nënkryetarin **Fatmir Iska**, drejtorët e drejtorive, juve anëtarë të nderuar të Komitetit për Politikë dhe Financa, përfaqësues të KFOR-it, zyrtarë komunalë, të gjithë juve që jeni të pranishëm! Faleminderit për pjesëmarrjen! E hapim mbledhjen e **dymbëdhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa** për vitin 2023.

Në konsultim me Kryetarin e Komunës, kemi përgatitur këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raporti i punës së ekzekutivit (kryetarit) për vitin 2023;
3. Shqyrtimi i Planit të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024;
4. Shqyrtimi i Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024;
5. Shqyrtimi i Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2024;
6. Shqyrtimi i Planit të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2024;
7. Shqyrtimi i Planit Lokal të Veprimit për Biodiversitet (2023-2027);
8. Shqyrtimi i Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit (2023-2027);
9. Raporti për zbatimin e Planit të Integritetit për vitin 2023;
10. Shfuqizimi i vendimit 01 Nr. 303/22, i datës 29.04.2022 për miratimin e Planit Komunal për Integritet (2022-2026);
11. Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktim të lokacionit për vendosjen e trafos elektrike, P- 01015-44 ZK-Xërxë;
12. Shqyrtimi i propozim-vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit në shfrytëzim të personave fizikë dhe juridikë, deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, P- 08152-0;
13. Shqyrtimi i Raportit të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës P- P- 08152-0; sipas vendimit 01 Nr. ____/23, i datës 00.12.2023;
14. Raport mbi realizimin e Planit të Punës së Zyrës Prokurimit për vitin 2023 dhe informatë mbi Planin Vjetor të Prokurimit Publik 2024;
15. Raporti i “Grantit të Performancës Komunale” për Komunën e Rahovecit për vitin 2022;
16. Të ndryshme.

Kryesuesi: Atëherë, nëse nuk keni ndonjë pikë shtesë, këtë rend dite e kalojmë në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash aprovohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: Atëherë, a kemi ndonjë diskutim? Nëse jo, po e vendosim në votim, kush është “për”? Me shumicë votash aprovohet pika e parë.

2. Raporti i punës së ekzekutivit (kryetarit) për vitin 2023;

Nënkryetari: Faleminderit, i nderuar kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, drejtorë, të pranishëm. Në plan janë paraparë zotimet e ekzekutivit komunal, përkatësisht të Kryetarit të Komunës. Prioritetet për 2024, si dhe sfidat që paraqiten gjatë zbatimit të planit. Në Zyrën e Kryetarit gjithashtu i keni edhe Planet e Punës: Zyra e Auditimit, Zyra e Integritimit Evropian, Zyra e Prokurimit, Zyra e Informimit etj. Gjithashtu planet e dymbëdhjetë drejtorive që veprojnë në kuadër të administratës komunale.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Në materialin që e kemi nuk kemi material të Raportit të Punës së Kryetarit. Megjithatë, ky rend dite duhet të plotësohet dhe të ndryshohet edhe një herë, duke i eliminuar pikat që nuk kanë material të bashkëngjitur.

Skender Hamza: Përshëndetje! Raporti i Punës së Kryetarit nuk ka qenë gati në momentin që ju kemi dërguar materialin. Është si pikë e rendit të ditës në KPF, si njoftim për kuvend.

Burim Krasniqi: Skend, më fal që po të thërras me emër, por nuk mund të diskutojmë diçka që nuk ekziston asnjë dokumentacion. Mund të vije në seancë si pikë shtesë dhe jo ne sot të diskutojmë mbi raportin e punës së kryetarit, sepse nuk kemi çka të diskutojmë. Propozoj që pikat e rendit të ditës që nuk kanë material, mos të jenë pjesë e rendit të ditës, por mund të jenë si pika shtesë në seancën e kuvendit!

Nënkryetari: Faleminderit! Kërkoj falje, faji është i yni që nuk është bërë ende gati dhe besoj që Raporti i Punës i Kryetarit do të jetë edhe në diskutim publik me datë të paraparë. Sot ju njoftoj që në seancën e kuvendit do ta kemi raportin gati. Raporti ka mbetur në fazën e lekturimit. Do ta keni të gatshëm pas redaktimit nga zonjushë Fjolla Duraku. Atë që unë e prezantova e bëra mbi bazën e materialeve që i pashë, pra, Planin e Punës së Kryetarit.

Burim Krasniqi: Nënkryetar, nuk e kam asnjë keqkuptim në raport me ekzekutivin. Konsideroj që Raporti i Punës i Kryetarit nuk duhet të jetë sot si pikë e rendit të ditës, sepse në momentin që kryesuesi drejtohet te ne nëse kemi diçka për diskutim, atëherë çka të diskutojmë? Raporti duhet të jetë si pikë shtesë në seancën e kuvendit.

Nënkryetari: Në cilësinë e ekzekutivit ju them që në seancën e kuvendit do ta kemi si pikë shtesë Raportin.

Burim Krasniqi: Skend, nuk mund të thuash që Raporti nuk votohet sepse mund të futet direkt në kuvend, e në të njëjtën kohë me thënë që KPF-ja është filtër i seancës. Kërkoj prej kryesuesit që pikat që nuk kanë material le të hiqen sepse është absurditet.

Kryesuesi: Është prezantuar rendi i ditës dhe është kaluar në votim. Nënkryetari i potencoi që te Raporti i Punës i Kryetarit realisht nuk kemi çka të diskutojmë, por është si pikë shtesë në mbledhjen e ardhshme. Nuk e di pse është e nevojshme që të kalohet në votim, për t'u hequr kjo pikë!

Burim Krasniqi: Po të ishte një informatë nga nënkryetari që mungon materiali, atëherë mirë, por ju nuk po ofroni asgjë.

Nënkryetari: Meqenëse po kërkohet, ne do ta kemi tani Raportin, veçse i ndërroni pikat sipas renditjes. Sa për informatë, nuk e besoj që në ndonjë kuvend komunal në Kosovë diskutohen raportet të cilësdo natyrë në KPF, por shkojnë direkt në kuvend. Ne jemi mjaft transparent dhe vazhdojmë të jemi.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë, drejtorë të drejtorive. Kërkoj mirëkuptim nga Burimi dhe ekzekutivi, sepse nuk është hera e parë që po ndodh e që nuk e kemi lënë pa

shkuar tutje çështja. Nga ekzekutivi kërkoj që kjo të jetë hera e fundit që në KPF ta kemi një pikë pa material.

Kryesuesi: Faleminderit, zt. Kafexhiu! Nëse jeni të pajtimit, këtë pikë e lëmë si pikë të fundit të rendit të ditës ose në kuvend si pikë shtesë.

3. Shqyrtimi i Planit të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024;

Nënkryetari: Atëherë, për shkak të atij lëshimi të vogël që e bëra, Planin e Punës së Kryetarit e prezantova pak më herët.

Defrim Kafexhiu: Te Plani i Punës së Kryetarit, atë që kam arritur ta shoh është që pothuajse 50% e materialit është i njëjtë (përshkrimi tekstual i prioriteteve të kryetarit) prej vitit 2017, d.m.th. prej vitit të parë të mandatit të dytë të Smajl Latifit. Po e marrim shembull Agroturizmin, që prej vitit 2017, prioriteti i njëjtë e punë nuk është bërë asgjë! Ju lutem, të paktën formën tekstuale ta formuloni ndryshe.

Nënkryetari: Afërsisht prioritetet mund të ndryshojnë, por ajo që na karakterizon ne si komunë, janë pikërisht prioritetet që vazhdojnë të përsëriten. Nëse ka dikush të zbulojmë diçka, do ta ketë përkrahjen tonë.

Kryesuesi: Atëherë, nëse nuk kemi diskutime të tjera, kalojmë në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me shumicë votash votohet kjo pikë e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024;

Skender Hamza: Përshëndetje! Sipas ligjeve në fuqi dhe Rregullores së Punës së Kuvendit, Plani i Punës aprovetur çdo vit nga anëtarët e kuvendit. Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët, funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore. Më 5 dhjetor, anëtarët e KPF-së, bashkë me ekzekutivin, kanë pasur një punëtori të organizuar nga OSBE-ja, ku prej anëtarëve të KPF-së janë kërkuar propozime të ndryshme për t'i futur në plan të punës së kuvendit. Para vetes e keni Planin e Punës, gjithashtu edhe vendimin. Nëse nga anëtarët e KPF-së e kemi edhe ndonjë propozim shtesë, jemi të hapur.

Defrim Kafexhiu: Ajo që i ka munguar kuvendit në 2 vitet e kaluara dhe që as për vitin e ardhshëm nuk është paraparë, e që harrova ta propozoj atje, besoj që e meritojmë si kuvend një ekskursion me Plan të Punës së Kuvendit. Besoj që tani i kemi rrethanat më të mira për realizimin e këtij organizimi.

Kryesuesi: Faleminderit Defrim! Në kuadër të Planit, përveç pikave të parapara, edhe kërkesa juaj do të bashkëngjitet.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Besoj që është e “udhës” që në aktivitetet e shënuara në Komunën e Rahovecit, duhet të ftohet edhe asambleja komunale. Qoftë te homazhet apo nderimet e dëshmorëve, është shumë më mirë të jetë e planifikuar si kuvend komunal bashkë me ekzekutivin, pavarësisht bindjeve politike. Kjo bën që të ekzistojë një respekt më i mirë reciprok ekzekutiv – asamble, sepse kur shkojmë si përfaqësues politikë duken më shumë si “fushatë” sesa si nderim.

Nënkryetari: Faleminderit! Te homazhet kolektive që i bëjmë si ekzekutiv ose si kuvend bashkë. Është mirë që në Plan të Punës të jenë seancat solemne, 17 Shkurti, 28 Nëntori, 14 Qershori dhe e dimë saktë që kemi homazhe të përbashkëta. Te datat e tjera për homazhe, si kuvend, nuk e di sa mund të përfshihen në Plan të Punës, por, nëse ju e vlerësoni ashtu, atëherë nuk ka problem.

Burim Krasniqi: Nuk mendoj që ndoshta kuvendi nuk shkon në të gjitha homazhet, por është Dita e Dëshmorëve në ditët e caktuara, masakrat e ndodhura në ditë të caktuara, Dita e Çlirimit të Rahovecit, e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe shumë data të caktuara (7-8 data) ku mund të shkojmë që gjithashtu kryesuesi me asambleistë ta ketë një kurorë me lule që e vendosë aty ku bëhen homazhet.

Kryesuesi: Atëherë, lidhur me propozimin e Burimit, diskutimin mund ta bëjmë edhe në mbledhjen e rregullt të kuvendit dhe pastaj të merren parasysh. Nëse nuk kemi diskutime të tjera, kalojmë në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash votohet edhe kjo pikë.

5. Shqyrtimi i Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për vitin 2024;

Nënkryetari: Faleminderit, kryesues! Në seancën e kaluar të KKSB-së, të cilën, në mungesë të kryetarit, e kam udhëhequr unë, kemi aprovuar Planin e Punës të KKSB-së për vitin 2024. Në bazë të udhëzimit administrativ, janë të parapara 6 seanca. Në 2023 i kemi mbajtur shtatë, kështu që, meqenëse është standard me qenë si pikë e rendit të ditës, kërkoj miratimin tuaj formal.

Kryesuesi: Atëherë, nëse nuk keni ndonjë gjë tjetër, po e vendosim në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i Planit të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2024;

Senad Mullaavda: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Plani i Punës i këshillit të fshatit është pothuajse i njëjtë si i vitit të kaluar, me disa ndryshime të vogla. Është përpiluar bashkërisht në mbledhje, ata i kanë dhënë propozimet e tyre, gjithashtu ju ftoj ta miratoni.

Burim Krasniqi: Nuk po e shoh askund që Këshilli i Hoçës së Madhe e bën punën e vet mjaftueshëm sa u përket proceseve të rëndësishme në Komunën e Rahovecit. Nuk e di nëse Këshilli i Hoçës së Madhe e ka dhënë ndonjë kontribut në PZhK, sepse nesër, për çdo ndërtim në atë pjesë, duhet ta marrim miratimin e tyre. E dyta, tash është procesi i Hartës Zonale dhe nuk po e shoh involvimin e tyre, ose së paku formalisht ata të pajtohen me këtë që po ndodh, që kur të vijmë në procesin e implementimit të këtyre projekteve mos të na dalin pengesa që vijnë prej Këshillit të Hoçës së Madhe. Besoj që proceset që paraprihen në planifikim para miratimit të dokumenteve të caktuara, lehtësojnë punën e ekzekutivit në implementimin e projekteve në të ardhmen.

Albnor Mullabazi: Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, anëtarë të KPF-së, drejtorë, pjesëmarrës. Brenda PZhK-së, Hoça e Madhe dhe Kanioni i Drinit nuk trajtohen në PZhK, do të trajtohen me një Plan Rregullues tjetër. PZhK-ja, një pjesë të Hoçës së Madhe e ka paraqitur si zonë e mbrojtur dhe për të hyrë brenda duhet të kemi një plan rregullues që merret veç me pjesën e mbrojtur të Hoçës së Madhe.

Burim Krasniqi: Drejtor, te Zona e Mbrojtur a futet tërë zona kadastrale, apo ka mundur të reduktohet? Sepse meqë jemi në procesin e Hartës Zonale, automatikisht edhe Hoça e Madhe duhet të përfshihet. Këshilli i Hoçës së Madhe duhet ta luajë rolin e vet si proces, gjithmonë duke u bazuar në kritere të parapara me ligj. Nuk po e shoh një kontribut serioz, tek e fundit, ne i kemi deleguar disa njerëz që nuk po e tregojnë mjaftueshëm procesin që qëndrojnë aty.

Albnor Mullabazi: Te PZhK-ja, ne e kemi trajtuar pjesën e Hoçës, është zonë ndërtimi. Me Plan Zhvillimor nuk kemi mundur t’u lëshojmë leje ose diçka të tillë, pa e pasur një Plan Rregullues për atë pjesë dhe për Kanionin e Drinit të Bardhë.

Senad Mullaavda: Faleminderit për vërejtjen! Me sa e di unë, këshilli i fshatit, në bashkëpunim me OSBE-në, janë duke e përpiluar një Plan Konservues, i cili parasheh mbrojtjen e monumenteve në sajë të zonës së mbrojtur. Ky plan nuk ka ardhur deri te miratimi në mungesë të PZhK-së dhe të Hartës Zonale. Për Planin Zhvillimor Komunal është mbajtur një mbledhje, por me këshillin lokal të fshatit, jo me këtë këshill që është formuar në bazë të ligjit.

Burim Krasniqi: Në Planin e Punës, nuk po e shoh që këshilli i Hoçës së Madhe e ka paraparë veten të involvuar në procese. Duhet ta dijë Asambleja se çka bën këshilli i Hoçës së Madhe, sepse e ka miratuar vetë. Roli i tyre është që ta rregullojnë raportin ekzekutiv – Hoçë e Madhe, sepse këtë obligim e ka nxjerrë Ligji për Hoçën e Madhe.

Nënkryetari: Këshilli i fshatit ka iniciuar një plan konservues duke mos i përfillur procedurat e mundshme dhe rastësisht kam qëlluar në një takim të tyre dhe e kemi stopuar. Në fakt ti nuk mund ta bësh një plan duke mos i respektuar procedurat.

Burim Krasniqi: Si anëtar i KPF-së, propozoj që në seancën e radhës, Këshilli i Hoçës së Madhe në planin e vet mujor, ta fusë veten në proceset e tjera që i zhvillon Komuna e Rahovecit (ta plotësojë tabelarin) dhe jo vetëm proceset e tyre të brendshme.

Defrim Kafexhiu: Burim, a është fjala që këshilli i fshatit të Hoçës së Madhe të përfshihet në procesin e hartimit apo të komentimit të PZhK-së në tërësi, apo vetëm për çështje të Hoçës së Madhe?

Burim Krasniqi: Harta Zonale e përfshin edhe Hoçën e Madhe. Nuk ka çka i intereson Hoçës së Madhe çka ndodh në Xërxë, se Xërxa e ka këshillin e fshatit.

Defrim Kafexhiu: Drejtori tha që me PZhK-në nuk përfshihet Hoça e Madhe. Në PZhK është e përfshirë vetëm si Zonë e Mbrojtur.

Kryesuesi: Faleminderit! Nëse dikush nuk ka edhe ndonjë gjë tjetër, e kalojmë pikën në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë me një votë kundër dhe të tjerat pro, votohet pika e gjashtë e rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i Planit lokal të Veprimit për Biodiversitet (2023-2027);

Albnor Mullabazi: Faleminderit, kryesues! Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit 03L/040 për Vetëqeverisje Lokale, e keni propozimin për miratim të Planit Lokal të Veprimit për Biodiversitet 2023-2027. Fillimisht është marrë një vendim i kryetarit për krijimin e grupit punues prej 16 anëtarëve. Para përgatitjes së draftit të planit, janë mbajtur tri takime. Është organizuar shqyrtimi publik, plani i ka kaluar këto procedura dhe tani është i gatshëm për miratim.

Defrim Kafexhiu: Në materialin e dërguar nuk po e gjej Planin për Biodiversitet, mos është ndonjë lëshim teknik?

Burim Krasniqi: Janë dy dokumente: Plani Lokal për Biodiversitet në word, e kur e hapim është vetëm propozim-vendimi i kryetarit të komunës dhe PDF propozim-miratimi i Planit Lokal për Biodiversitet është përsëri vetëm propozim-vendimi i kryetarit. Tek i pari është pa nënshkrim, i dyti me nënshkrim.

Skender Hamza: E tëra kjo ka ardhur si pasojë e ngarkesë së madhe në dokumente.

Kryesuesi: Faleminderit! Nëse dikush nuk ka edhe ndonjë gjë tjetër, e kalojmë pikën në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë me shumicë votash votohet kjo pikë e rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i Planit lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit (2023-2027);

Albnor Mullabazi: Në mbështetje të nenin 13 dhe 15 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, para jush e keni propozimin për Planin Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2023 – 2027. Procedurat pothuajse janë të njëjta si për planin paraprak. Bashkë me kompaninë hartuese, janë mbajtur takime gjatë përgatitjes së draftit. Pas kësaj ka kaluar në shqyrtim publik (1 muaj) dhe të gjitha vërejtjet, komentet dhe sugjerimet janë involvuar në plan.

Defrim Kafexhiu: Te çështja e cilësisë së ajrit, nuk e pashë që është e përfshirë pjesa e investimit që është duke u planifikuar të bëhet me energji të ripërtëritshme në Zatriq. A mund të hasim me ndonjë mospërputhje në mes të investimit dhe të planit i cili pritet të miratohet?

Burim Krasniqi: Drejtor, a ka pasur kompani profesionale të angazhuar, apo vetëm grupi punues e ka bërë tërë punën?

Kryesuesi: Faleminderit, Burim! Nëse dikush nuk ka edhe ndonjë gjë tjetër, e kalojmë pikën në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me shumicë votash, votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

9. Raporti për zbatimin e Planit të Integritetit për vitin 2023;

Valmir Gashi: Përshëndetje për të gjithë! Sa i përket raportit për zbatimin e Planit të Integritetit, ai është i bazuar në dy fusha të rrezikut, fushën e përgjithshme të rrezikut (34 masa, 32 të zbatuara) dhe fushën e veçantë të rrezikut (64 masa, 61 të zbatuara).

Kryesuesi: Faleminderit, Valmir Gashi! Nëse dikush nuk ka edhe ndonjë gjë tjetër, e kalojmë pikën në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me shumicë votash, votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

10. Shfuqizimi i vendimit 01 Nr. 303/22, i datës 29.04.2022 për miratimin e Planit Komunal për Integritet (2022-2026);

Valmir Gashi: Në bazë të ligjit të ri dhe Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Planet e Integritetit duhet të miratohen nga Kryetari i Komunës dhe jo nga Kuvendi. Planet duhet të përditësohen çdo vit dhe sipas ligjit, ky plan duhet të shfuqizohet.

Burim Krasniqi: Me një vend e kemi planin, me një tjetër jo. Nëse e miraton vetëm Kryetari i Komunës, atëherë cili është roli i Asamblesë Komunale. Çka ndodh më pas? Kërkoj që në seancën tjetër të vije Plani i Integritetit. Të njëjtën kohë kërkon shfuqizimin dhe më pas Asambleja nuk e miraton, d.m.th. do të mbetet vetëm “Informatë mbi Planin e Integritetit”.

Valmir Gashi: Në bazë të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (ligjit), kërkohet që Kryetari i Komunës t’i aprovojë këto plane dhe gjithashtu raportimi i bëhet vetëm Kryetarit të Komunës dhe Agjencisë.

Nënkryetari: Shfuqizimi kërkohet sepse ky plan është miratuar nga Kuvendi Komunal, pra, shfuqizimi kërkohet prej organit të njëjtë.

Kryesuesi: Faleminderit! Nëse dikush nuk ka edhe ndonjë gjë tjetër, e kalojmë pikën në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me shumicë votash, votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

11. Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktim të lokacionit për vendosjen e trafos elektrike, P- 01015-44 ZK-Xërxë;

Afrim Oruqi: Faleminderit, kryesues! Sipas ligjeve në fuqi, bëhet fjalë për një propozim nga Kryetari i Komunës në zonën kadastrale në Xërxë, me nr. 1015-44. Prej sipërfaqes së përgjithshme 2ha, 87 ari e 84m², po e shpallim vend për caktim të lokacionit vetëm 50m². Kjo është pronë e komunës që menaxhohet nga DKRS-ja, kërkojmë që, përveç ndarjes së kësaj parcele, t’i hiqet e drejta DKRS-së nga menaxhimi me qëllimin e vetëm për vendosje të trafos elektrike.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Nëse dikush nuk ka edhe ndonjë gjë tjetër, e kalojmë pikën në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me shumicë votash, votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

12. Shqyrtimi i propozim-vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit në shfrytëzim të personave fizikë dhe juridikë, deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, P- 08152-0;

Afrim Oruqi: Faleminderit, kryesues! Bëhet fjalë për zonë kadastrale në Rahovec me sipërfaqe të përgjithshme 27 ari. Kërkojmë të marrim vendim bashkë me juve që në sipërfaqe prej 20 ari, ta japim me qira deri në 15 vjet.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Nëse dikush nuk ka edhe ndonjë gjë tjetër, e kalojmë pikën në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me shumicë votash, votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

13. Shqyrtimi i Raportit të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës P- P- 08152-0; sipas vendimit 01 Nr. ____/23, i datës 00.12.2023;

Afrim Oruqi: Sipas ligjit, obligohemi ta formojmë një komision për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave, në përbërje prej pesë anëtarëve për parcelën (08152-0), që morëm vendim më herët.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Atëherë, e kalojmë në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash votohet kjo pikë e rendit të ditës.

14. Raport mbi realizimin e Planit të Punës së Zyrës së Prokurimit për vitin 2023 dhe informatë mbi Planin Vjetor të Prokurimit publik 2024;

Astrit Mullabazi: Faleminderit, kryesues! Ky është planifikimi paraprak i prokurimit për vitin 2024, i dërguar te Kryetari i Komunës më datë 01.12.2023, ku janë të përfshira të gjitha aktivitetet e prokurimit për 2024. Planifikimi përfundimtar i prokurimit dorëzohet në Agjencionin Qendror të Prokurimit, 15 ditë pas miratimit të buxhetit në nivel qendror.

Leonard Morina: Faleminderit, kryesues! Faleminderit, Astrit! Përshëndetje për ekzekutivin dhe të gjithë të pranishmit. Te tabela e “furnizimit me pelet për nevojat e komunës”, njësia është me ton, kërkohet 328 ton, çmimi për njësi është 150.000€ dhe kontrata totale 150.000. Pse nuk është vendosur çmimi për njësi?

Astrit Mullabazi: Leonard, kjo është hera e parë, për shkak të një vërejtjeje të vogël, që e kemi pranuar nga organizata INPO. Jemi munduar që te pjesa e furnizimeve ta vendosim sasinë e përafërt të planifikuar.

Burim Krasniqi: Faleminderit për këtë elaborim! I kam dy çështje: Te ndërtimi i rrugës dhe urës që lidh rrugën “Ibrahim Rugova” me atë “Muharrem Dina” te Sheshi Qendror, a nënkupton kjo që ndërtimi i sheshit e rrit koston edhe për 350.000€? E dyta, a do të jetë anekskontratë apo kontratë e re? E treta, kur janë dy kontrata në shesh, si do të ndodhë përgjegjësia e implementimit. Pyetja e dytë ka të bëjë me ndërtimin e kolektorit dhe të shtratit të lumenjve Hoçë e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac, Krushë e Madhe. Këto çështje do t’i diskutoj edhe në asamble më detajisht, sepse këtu janë investuar rreth 700.000€ në disa gypa, çka do të ndodh tutje? A do të jetë investim prej ministrisë për këtë projekt, apo prej mjeteve të komunës, nëse po, a ka siguri të zotimit të mjeteve në këtë projekt gati prej 2.9 milion?

Astrit Mullabazi: Këtu ceket planifikimi, është përgatitur sipas kërkesës dhe të dhënave që ka pranuar nga njësitë. Sa për titujt e projekteve dhe a ka mbulueshmëri financiare, është përgjegjësi e drejtorëve dhe jo e Zyrës së Prokurimit.

Burim Krasniqi: Loja e ping-pongut ndonjëherë është e mirë. A guxon Zyra e Prokurimit të shpallë tender pa mjete të mjaftueshme? Po më vjen keq, por pa mjete dhe pa zotimin e tyre nuk mundesh. Roli i shefit të prokurimit, përveç procedurave që duhet t’i kryejë, është edhe për të korrigjuar diçka.

Defrim Kafexhiu: Ashtu siç po kërkon Burimi, nuk besoj që ndoshta mund të bohet ndonjë projekt, te forma që të presim për zotimin e mjeteve. Në Komunë të Rahovecit jemi.

Biondina Kleçka: Faleminderit, kryesues! E pashë që është në planifikim dekorimi i qytetit, më intereson kur do të përfundojë dhe ku mendohet të bëhet dekorimi?

Kryesuesi: Biondinë, ishim te diskutimi i Planit të Punës së Prokurimit, te pika e fundit (të ndryshme), do ta merrni përgjigjen.

15. Raporti i “Grantit të Performancës Komunale” për Komunën e Rahovecit për vitin 2022;

Skender Hamza: Në kuadër të Grupit të Performancës, meqë koordinatorja nuk është prezente, po e marr unë fjalën. Material përsëri nuk ka, Burimi mund të japë përsëri vërejtje me të drejtë. Realisht, ende nuk ka arritur raporti prej ministrisë nëpër komuna dhe kjo ka qenë arsyeja që e kemi vendosur aty si njoftim, sepse është indikator që kërkohet prej donatorëve të performancës. Në momentin që ministria na dërgon, ne do t’ju dërgojmë menjëherë.

Kryesuesi: Faleminderit! Atëherë, para se të kalojmë në pikën e fundit, e kemi Shefin e Kabinetit të Kryetarit, për elaborim te pika e dyte (Raporti i Punës së ekzekutivit (kryetarit) për vitin 2023).

Ali Morina: Faleminderit, kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, fillimisht ju kërkoj falje për këtë lëshim, materiali nuk ka qenë gati për arsye të elementeve teknike. Në këtë raport janë të përfshira në vija të trasha raportet e punës së drejtorive komunale dhe të zyrave (në kuadër të zyrës së kryetarit). Në momentin që do të jetë gati raporti, do ta keni nëpër e-maila.

16. Të ndryshme;

Afrim Dina: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë, anëtarë të KPF-së! Para tri ditësh kemi filluar me dekorim, do të dekorohet pjesa e rrugës te lokalet e palestrës, pjesa e parkut, do të kemi dekorim edhe te tri rrethrotullimet që i kemi në qytet nga Suhareka, Malisheva dhe pjesa poshtë te Viva. Gjithsesi do të dekorohen edhe drunjtë dekorativ deri te semaforët. Dekorim do të ketë edhe në rrethrotullim të fshatit Xërxë, Krushë e Madhe dhe Ratkoc. Për dy ditë besoj që do ta përfundojmë.

Defrim Kafexhiu: Po më vjen shumë mirë veç që e keni planifikuar dekorimin e vendeve, por më duket që është pak vonë. Kur përfundon dhe sa ditë mund ta shijojmë ne dekorimin, para Vitit të Ri? Meqenëse është pak më i zgjeruar planifikimi i ndriçimit, sa e ka koston për këtë vit?

Kryesuesi: Për këtë vit, kanë qenë të planifikuara 4000€. Operatori ka ofertuar me vlerë 3870€. Besoj që sot edhe nesër do të përfundojë.

Burim Krasniqi: Një pyetje e kam për seancë. Nuk e di kush është menaxher i projektit të përroskës në fshatin Celinë. Kam video dhe foto që në reshjet e fundit është shfaqur problem për shkak të mostrajtimit të drejtë të kullimit të ujërave. Te kjo pjesë në rrugë, ka pasur prezencë të madhe të ujërave. Kërkoj që në seancën e radhës ta jepni një shpjegim për këtë gjë dhe a është i paraparë edhe kullimi i ujit që vjen prej rrugës?

Kryesuesi: Faleminderit! Në fund, ju informoj që në seancën e ardhshme të kuvendit, si pikë shtesë do të jetë: Vendimi për subvencionimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit 2024. Atëherë, këtu përfundon mbledhja e dymbëdhjetë e KPF-së.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

